

Posta e jonë.

Pajtimtarëve, me rrezik qi me dalë të merzitshem, sado qi nuk dim se kush ka më arsye me u merzitë a na qi mudohe-mi me u ndëjë detyrës së randë qi i vûme vedit, a por ata qi nuk duen të paguejnë me kohë, pajtimtarëvet, po thona, jemi tuj jau drejtue edhe nji lutje, qi mos të na lân mâ kshtû pezull e të diftohen nji grimë mâ bujarë ndaj shtypin komtâr.

Lozanë. Dr. T. — Na ndieni per vonesë. Po u dergojmë per tash vetem nji Numer, masi kemi frigë se ndoshta nuk gjendeni mâ aty. Na diftoni drejtimin e sugurtë.

Athinë. M. F. — U falena nderës per leter, do të perkundesemi per tëgjitha. Edhe broshuren do të jau gjëjmë e do të jau nisim per së shpejti.

Bizë P. T. G. — Per „Hyllin“ nuk ka me kënë gjâ, masi Perkohëshmja e jonë nuk e ndjekë mâ at rubrikë. Do t'u kondendojmë gjithnji me mjete tjera.

Tiranë. D. Sh. — T'a shvilluemen pûnen aq sa lypet, do t'u shkruemjë. Per tash nji herë nuk dim ç'me thânë. Shum shndet.

HYLLI I DRITËS

Vjeta IV.

KORRIK 1923

Numri VII.

Arsim, a po luftë kundra katolikizmit në Shqypni?

I.

Druem se kemi ndrrue qymen, por jo vesin.

Diten qi Shqypnija pat fatin e bardhë, me u skapullue zgjedhet të mnishme të Turkis e me këndë njoftë zyrtarisht prej botet të gytetnueme per Shtet i pamvarshem e pjestare e „Lidhjes s' Komeve“, në Shqyptarve na u tfaq një problem i madh per t'a zhdrivilluem: jeta shoqnore në Shqypni a do të zhdrivillohej mbas systemit azjatic? a po mas kulturet okcidentale t' Europës? E pse nuk mund të kuptohej, qi „Lidhja e Komeve“ do t'a ngrofte per një mot të gjatë në gjë të vet një Shtet europjan, të ndertuem mbi ligjë e parime barbare e semibarbare, zhdrivillimi i ktij problemi na tatohej me ngutsi; pse, e shkputne prej „Lidhjetj të Komeve“, vshtirë se Shqypnija mund do të kishte gzue pamvarsin e vet politike.

Veç shka se zhdrivillimi i ktij problemi na parashtrohej me vshtirsi e pengime të mdhaja fort e, të thuesh të pashkapercyeshme; pse der sa m'njan'anë kultura okcidentale impozohej per arsye shoqnore, politike e ekonomike, m'tjetren anë systemi azjatic nuk mund do të shkulej me rrājë prej Shqypnijet, mbasi ky ishte njëpernjisue me besimin muhamedan, të cillin e dishmon shumica e Shqyptarve. E as nuk ishte rasa me mendue per një

